LIGJ
Nr. 127/2020

PËR REGJISTRIMIN, MËNYRËN E PËRDORIMIT DHE KONTROLLIN E MJETEVE LUNDRUESE TURISTIKE DHE TË ARGËTIMIT

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj rregullon mënyrën elektronike të regjistrimit, të përdorimit dhe të kontrollit të mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit, të klasifikuara si të tilla nga shoqëria klasifikuese, me kapacitet deri në 12 pasagjerë, pa përfshirë ekuipazhin e mjetit lundrues, me motor me fuqi mbi 30 kilovatë/orë (KW) ose 40.8 kuaj/fuqi (KF) dhe tonazh nën 500 grostonë (GT).

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për mjetet lundruese turistike dhe të argëtimit, të klasifikuara si të tilla nga shoqëria klasifikuese, me kapacitet deri në 12 pasagjerë, pa përfshirë ekuipazhin e mjetit lundrues, me motor me fuqi mbi 30 KW ose 40.8 KF dhe tonazh nën 500 GT, që mbajnë flamurin shqiptar ose përdorin hapësirën detare shqiptare dhe ujërat e brendshme tokësore.
2. Ky ligj nuk zbatohet për mjetet lundruese në përdorim të Forcave të Armatosura, të kapitanerisë së porteve, të forcave të policisë, të doganave dhe të organeve të tjera të parashikuara me ligj.

Neni 3
Përkufizime

1. Për qëllimin e këtij ligji përkufizimet kanë këto kuptime:

a) "Certifikatë regjistrimi" është dokumenti që përfitohet pas regjistrimit të pronësisë për mjete lundruese mbi 15 ml.

b) "Certifikatë sigurie apo të klasit" është dokumenti i lëshuar nga shoqëria klasifikuese, krijuar sipas dispozitave të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë.

c) "Deti territorial" përfshin hapësirën detare nga vija e drejtë bazë në drejtim të detit në distancën 12 milje detare ose me vijën delimituese të arritur me marrëveshje me fqinjët detarë.

ç) "Dëshmi drejtimi për mjete të vogla lundruese" është dokumenti i aftësisë së drejtimit të mjetit.

d) "Dëshmi e aftësisë së lundrimit për mjete të vogla lundruese" është dëshmia e regjistrimit për mjete të vogla lundruese deri në 15 ml.

dh) "Hapësira detare" përfshin detin e brendshëm dhe detin territorial të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të Konventës së OKB-së për të drejtën e detit 1982, ratifikuar me

ligjin nr. 9055, datë 24.4.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën mbi të Drejtën e Detit të OKB-së".

e) "Mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtim" janë mjetet sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për aktivitetet e turizmit detar, me tonazh nën 500 GT, që kanë një fuqi të përgjithshme të motorit ose të motorëve të marrë së bashku më të lartë se 30 KW ose 40.8 KF, të klasifikuara si të tilla nga Regjistri Detar Shqiptar ose nga institucionet korresponduese të shteteve të tjera, që përdoren për qëllime turistike dhe argëtimi.

ë) "Regjistri Elektronik i Detarëve të Mjeteve Lundruese" është regjistri elektronik i detarëve, që disponojnë dëshminë profesionale përkatëse për të drejtuar dhe/ose punuar me mjetet lundruese, objekt i këtij ligji.

f) "Regjistri Elektronik i Mjeteve Lundruese" është regjistri elektronik i mjeteve lundruese objekt i këtij ligji.

g) "Regjistrim" është regjistrimi fillestar i mjeteve lundruese në regjistrin fizik të pronësisë.

gj) "Sistemi i posaçëm elektronik për lëvizjen e mjeteve lundruese" është sistemi elektronik i raportimit të aktivitetit lundrues të mjeteve të përshkruara në këtë ligj.

h) "Ujëra të brendshme tokësore" përfshijnë edhe hapësirat ujore në territorin tokësor, si: lumenjtë, liqenet, rezervuarët, kënetat etj.

i) "Ujërat e brendshme" ka të njëjtin kuptim sipas legjislacionit në fuqi për aktivitetet e turizmit detar.

j) "ZRMLD" është zyra e regjistrimit të mjeteve lundruese dhe detare pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

k) "Regjistri Elektronik i Shërbimeve të Mjeteve Lundruese" është regjistri elektronik i subjekteve që prodhojnë, ristrukturojnë apo riparojnë mjete lundruese, që rregullohen me këtë ligj, si dhe çdo veprim apo ndërhyrje që kryhet në mjetet lundruese.

l) "Survejimi i mjeteve lundruese" është shërbimi që kryhet nga subjekte fizike ose juridike të licencuara, i cili mund të delegohet nga autoritetet përkatëse të administratës detare apo pronarët e anijeve për të kryer inspektime dhe survejime në mjetet lundruese dhe dhënien e rekomandimeve.

KREU II

Neni 4
Procedura e regjistrimit, lëshimit të certifikatës së sigurisë apo të klasit dhe drejtimit të mjeteve lundruese turistike dhe argëtimit

1. Aplikimi për regjistrimin e mjeteve lundruese bëhet pranë ZRMLD-së, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, nga pronari ose personi i autorizuar prej tij.

2. Në funksion të regjistrimit ose lëshimit të certifikatës, administrata detare apo shoqëria klasifikuese e njohur prej saj kryen verifikimet, sipas parashikimeve ligjore, nëpërmjet inspektorëve të saj ose personave fizikë/juridikë të licencuar për ushtrimin e veprimtarisë së survejimit të mjeteve lundruese.

3. Subjekti i licencuar për kryerjen e shërbimit të survejimit, pas njohjes nga administrata detare, verifikon mjetin dhe dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim.

4. Lëshimi i certifikatave të sigurisë dhe të klasit bëhet nga shoqëria klasifikuese e njohur nga administrata detare shqiptare. Periudha e vlefshmërisë së certifikatës së sigurisë do të përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin detar.

5. Për certifikatat e lëshuara nga shoqëri klasifikuese të huaja, shoqëria klasifikuese e njohur nga administrata detare shqiptare lëshon certifikatën përkatëse shqiptare.

6. Shoqëritë klasifikuese të huaja, të cilat do të njihen nga shoqëria klasifikuese e njohur nga administrata detare shqiptare, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin detar.

7. Drejtimi i mjeteve lundruese, objekt i këtij ligji, bëhet nga persona të kualifikuar. Kriteret e kualifikimit dhe kategorive të drejtimit të këtyre mjeteve përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin detar.

Neni 5
Detyrimi i përgjithshëm

1. Mjetet lundruese, objekt i këtij ligji, duhet të respektojnë rregullat dhe normat e regjimit të lundrimit në det dhe në ujërat e brendshme tokësore, sipas parashikimeve të konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.
2. Mjetet lundruese shqiptare, objekt i këtij ligji, duhet të jenë të pajisura me Sistemin Automatik të Identifikimit (AIS) në zbatim të konventës ndërkombëtare "Për sigurinë e jetës në det (SOLAS)"dhe ta kenë funksional përgjatë gjithë periudhës që ndodhen në hapësirën detare shqiptare.
3. Mjetet lundruese, objekt i këtij ligji, në çdo rast duhet të kenë në bord dhe të paraqesin me kërkesën e autoriteteve përgjegjëse dokumentacionin e mëposhtëm:
a) dokumentin e identifikimit;
b) certifikatën e sigurisë së mjetit lundrues ose dokumente të tjera të klasit;
c) dëshminë e aftësisë së lundrimit për mjetin e vogël lundrues ose certifikatën e regjistrimit;
ç) dëshminë e aftësisë së drejtimit për mjetin lundrues;
d) policën e sigurimit për dëmet ndaj të tretëve.
4. Mjetet lundruese me fuqi motorike më të vogël se 30 KW ose 40.8 KF, me distancë lundrimi deri në 1 milje nga bregu, regjistrohen vetëm në ZRMLD.
5. Mjetet lundruese, të parashikuara në pikën 4 të këtij neni, zbatojnë të gjitha rregullat dhe detyrimet e sigurisë e të lundrimit të parashikuara në këtë ligj, por përjashtohen nga pajisja me sistemin GPS. Drejtuesit e këtyre mjeteve përjashtohen nga detyrimi për t'u pajisur me dëshmi aftësie drejtimi.

Neni 6
Njoftimi për operimin e mjetit lundrues

1. Mjetet lundruese turistike dhe ato për qëllime argëtimi njoftojnë kapitanerinë e portit nëpërmjet sistemit të posaçëm elektronik, në nisje dhe në mbërritje.
2. Njoftimi për hyrjen dhe daljen ose lëvizjen në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë bëhet në sistemin e posaçëm elektronik të lëvizjes së mjeteve lundruese.
3. Njoftimi për lëvizje duhet të përfshijë si më poshtë:
a) emrin e mjetit, numrin e regjistrimit;
b) emrin e drejtuesit të mjetit;
c) orën e përafërt të nisjes/mbërritjes;
ç) destinacionin;
d) numrin dhe gjeneralitetet e personave në bord.

Neni 7
Regjistri Elektronik i Mjeteve Lundruese

1. Drejtoria e Përgjithshme Detare krijon, mirëmban dhe përditëson Regjistrin Elektronik të Mjeteve Lundruese.
2. Me qëllim kryerjen e verifikimeve të nevojshme brenda fushës së përgjegjësisë, në këtë sistem do të kenë të drejtë aksesi organet shtetërore të njohura me ligj.
3. Regjistri Elektronik i Mjeteve Lundruese do të vendoset në funksion nga data 1 janar 2022.

4. Deri në vënien në funksionim të Regjistrit Elektronik shkëmbimi i informacionit me institucionet ligjore do të kryhet në rrugë elektronike nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.

5. Përmbajtja, formati, rregullat e krijimit dhe të përditësimit të regjistrave elektronikë të mjeteve lundruese dhe të sistemit të posaçëm elektronik përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin detar dhe ministrit përgjegjës për Policinë e Shtetit.

6. Funksionimi i regjistrave elektronikë dhe i sistemit të posaçëm elektronik për lëvizjen e mjeteve lundruese do të miratohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin detar dhe ministrit përgjegjës për Policinë e Shtetit.

KREU III

Neni 8
Deklarimi pas importimit

1. Subjekti që importon një mjet lundrues, objekt i këtij ligji, përveç ndjekjes së procedurave doganore të parashikuara, duhet të bëjë deklarimin me shkrim tek autoritetet e Policisë Kufitare, pranë pikave të kalimit kufitar, duke shënuar vendqëndrimin dhe vendbazimin e mjetit lundrues, gjeneralitetet e pronarit ose të bashkëpronarëve, si dhe të subjektit importues.

2. Brenda 10 ditëve nga importimi, pronari ose bashkëpronarët duhet të bëjnë regjistrimin e mjetit lundrues pranë ZMRLD-së.

Neni 9
Ndryshimi i kushteve dhe pronësisë

1. Çdo subjekt që përfiton ose mban me çfarëdolloj titulli një mjet lundrues ose pjesë të tij, duhet të bëjë deklarimin brenda 24 orëve nga marrja në zotërim ose në mbajtje në sistemin e posaçëm për deklarimin e lëvizjes së mjetit, duke shënuar gjeneralitetet dhe vendqëndrimin e tij, vendbazimin e përhershëm të mjetit, si dhe gjeneralitetet e pronarit ose të bashkëpronarëve.

2. Pronari ose bashkëpronarët e mjetit lundrues dhe personi i autorizuar janë të detyruar të njoftojnë brenda 24 orëve në sistemin e posaçëm për deklarimin e lëvizjes së mjeteve çdo ndryshim që ka të bëjë me një ose disa nga kushtet e mëposhtme:

a) ndryshimi i titullarit të pronës ose të përdorimit;
b) zëvendësimi i personit të autorizuar për drejtimin e mjetit ose përdoruesit të mjetit;
c) ndryshimi i vendbanimit të personave të mësipërm;
ç) ndryshimi i vendbazimit të përhershëm të mjetit;

3. Pronari ose bashkëpronarët e mjetit lundrues dhe personi i autorizuar janë të detyruar të bëjnë ndryshimin e pronësisë pranë ZRMLD-së brenda 10 ditëve.

4. Brenda 5 ditëve nga paraqitja e njoftimit të ndryshimit, ZRMLD-ja duhet të bëjë regjistrimin e ri dhe të lëshojë një dëshmi të re lundrimi.

5. Deri në lëshimin e dëshmisë së re të lundrimit, mjeti lundrues nuk mund të zhvendoset nga vendi i ruajtjes dhe as të përdoret për çfarëdolloj qëllimi.

6. ZRMLD-ja njëkohësisht me ndryshimet në regjistrat fizikë bën edhe ndryshimin në Regjistrin Elektronik të Mjeteve Lundruese.

KREU IV

Neni 10
Fabrikat dhe kantieret detare

1. Fabrikat dhe kantieret detare, të certifikuara nga shoqëria klasifikuese e njohur nga administrata detare shqiptare, që ndërtojnë, ristrukturojnë objekte të këtij ligji, ndërveprojnë me regjistrin elektronik të shërbimeve të mjeteve lundruese për ndërtimin, rikonstruktimin dhe riparimin.

2. Në regjistër do të shënohen në mënyrë kronologjike të dhënat që kanë të bëjnë me çdo prodhim, ristrukturim e riparim: modeli, numri i matrikullës së prodhimit, emri i mjetit, gjeneralitetet e plota të blerësit, të pronarit, të bashkëpronarëve ose të ceduesit dhe atij që e ka transportuar e dorëzuar mjetin lundrues.

KREU V

Neni 11

Mjetet lundruese të regjistruara jashtë shtetit

1. Shtetasi shqiptar, shtetasi i huaj ose pa shtetësi, pronar ose mbajtës i mjeteve lundruese, që nuk janë të regjistruara në Shqipëri, duhet të deklarojë në sistemin e posaçëm elektronik për lëvizjen e mjeteve lundruese në çastin e mbërritjes në port, përveç të dhënave të tjera, kohën e parashikuar të qëndrimit në ujërat territoriale shqiptare.

2. Përveç sa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni dhe detyrimeve të tjera që rrjedhin nga legjislacioni për lundrimin, pronarët ose mbajtësit e mjeteve lundruese, të regjistruara jashtë shtetit, të cilët duan të qëndrojnë në ujërat territoriale shqiptare për një periudhë më të gjatë se 18 muaj, i nënshtrohen detyrimit të regjistrimit.

3. Për regjistrimin e tyre duhet të paraqiten dokumentet sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin e mjeteve lundruese.

Neni 12

Kontrollet e mjeteve lundruese

1. Mbi bazën e regjistrave elektronikë të administrimit të mjeteve lundruese, sistemit të posaçëm elektronik për lëvizjen e mjeteve lundruese dhe mbi bazën e analizës së riskut, Policia Kufitare ushtron kontrolle specifike për dokumentacionin, për zbatimin e rregullave të lundrimit dhe të sigurisë së mjeteve lundruese, objekt të këtij ligji, si dhe për veprime të kundërligjshme brenda fushës së kompetencës.

KREU VI

Neni 13

Ndalime

1. Personat, të cilët janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi në fushën e terrorizmit, trafikimit të qenieve njerëzore, të lëndëve narkotike, të armëve, të lëndëve kimike dhe radioaktive, të kalimit të paligjshëm të kufirit, ose të transportit të kundërligjshëm të mjeteve monetare, nuk kanë të drejtë të drejtojnë ose të mbajnë në përdorim të çdo lloj forme mjete lundruese, objekt të këtij ligji. Përdoruesi i mjetit lundrues, përpara marrjes se kualifikimit të drejtimit të mjetit lundrues, objekt i këtij ligji, plotëson formularin e vetëdeklarimit, ku deklaron se nuk rezulton i dënuar për veprat e lartpërmendura. Formulari i vetëdeklarimit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për transportin detar.

2. Ndalohet përdorimi i mjeteve lundruese të paregjistruara.

KREU VII
SANKSIONET

Neni 14
Kundërvajtjet administrative

1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) mungesa e regjistrimit të pronësisë së mjetit brenda afatit të parashikuar në nenet 8 dhe 9, të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë;

b) mungesa në bordin e mjetit lundrues e dokumenteve të përmendura në nenin 5, të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë dhe me bllokim administrativ të mjetit lundrues;

c) refuzimi për vendosjen në dispozicion të dokumenteve të parashikuara në nenin , të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe me bllokim administrativ të mjetit lundrues për 30 ditë;

ç) mosdeklarimi i importimit në përputhje me pikën 1, të nenit 8, të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe me bllokimin administrativ të mjetit lundrues për 60 ditë;

d) mosdeklarimi në sistem i zotërimit ose i mbajtjes së mjetit lundrues brenda afatit dënohet me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe me bllokim administrativ të mjetit lundrues për 60 ditë;

dh) përdorimi i një mjeti lundrues, objekt i këtij ligji, të paregjistruar, dënohet me gjobë në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe bllokim administrativ të mjetit për 60 ditë;

e) falsifikimi i karakteristikave teknike të mjetit lundrues, i fuqisë së motorit ose të motorëve, ose ndryshimi i tyre pa i deklaruar pranë ZRMLD-së, dënohet me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe me bllokim të mjetit lundrues;

ë) mosmbajtja e regjistrave në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 10, të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë;

f) mosdeklarimi i ndryshimeve të parashikuara në nenin 9, të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Nëse kjo shkelje përsëritet, dënohet me dyfishin e gjobës dhe bllokimin e mjetit lundrues për 30 ditë;

g) transporti me një mjet lundrues, objekt i këtij ligji, të një numri jo më të madh se 1/2 e personave mbi limitin e përcaktuar në lejen e lundrimit dhe në certifikatën e sigurisë apo të klasit, dënohet me gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo person mbi numrin e lejuar;

gj) transporti me një mjet lundrues, objekt i këtij ligji, të një numri më të madh se 1/2 e personave mbi limitin e përcaktuar në lejen e lundrimit dhe në certifikatën e sigurisë apo të klasit, dënohet me gjobë në masën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe me bllokim të mjetit lundrues për 30 ditë;

h) kryerja nga mjeti lundrues, objekt i këtij ligji, i një veprimtarie të kundërligjshme në fushën e terrorizmit, të trafikut të qenieve njerëzore, të trafikut të lëndëve narkotike, të armëve, të lëndëve kimike dhe radioaktive, transportit të kundërligjshëm të mjeteve monetare, dënohet me konfiskim të mjetit lundrues dhe të çdo mjeti tjetër që ka shërbyer për transportin e tij;

i) shkelja e kalimit paqësor dënohet me gjobë në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë;

j) drejtimi i mjetit lundrues nën efektin e pijeve alkoolike ose të substancave narkotike apo psikotrope dënohet me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe me heqje të dëshmisë së aftësisë për drejtimin e mjetit lundrues për 60 ditë;

k) shkelja e ndalimit të përcaktuar në pikën 1, të nenit 13, të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe bllokim të mjetit lundrues për 30 ditë.

2. Në rast konstatimi të shkeljes së parashikuar në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, pronari, bashkëpronari ose drejtuesi i mjetit lundrues ka detyrimin që brenda 2 ditëve të vendosë

në dispozicion të zyrës kompetente të Policisë Kufitare dokumentet e kërkuara. Nëse këto dokumente nuk paraqiten brenda këtij afati, mjeti lundrues bllokohet me urdhër të drejtuesit të zyrës së Policisë Kufitare kompetente për 90 ditë. Mosparaqitja e dokumenteve edhe gjatë kësaj periudhe kohore, sjell si pasojë konfiskimin e mjetit lundrues.

3. Në rast përsëritjeje më shumë se një herë të shkeljeve të parashikuara në shkronjën "ë", të pikës 1, të këtij neni, dënimi me gjobë shoqërohet me mbylljen e fabrikës apo të kantierit detar nga 30 deri në 60 ditë.

4. Oficeri ose agjenti i Policisë Kufitare, që ka bërë kontrollin, zbaton masat e dënimit të përcaktuara në këtë nen, duke respektuar procedurën e parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

5. Shpenzimet e depozitimit të mjetit lundrues përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e brendshme dhe janë në ngarkim të kundërvajtësit.

KREU VIII

Neni 15
Pjesët e mjeteve lundruese

Dispozitat e parashikuara në sanksionet e këtij ligji zbatohen edhe kur bëhet fjalë për pjesë të mjeteve lundruese, të cilat në bazë të të dhënave të bazuara, të vendndodhjes, të mënyrës së fshehjes në ngarkim të pronarit ose të bashkëpronarëve, të mbajtësit ose të zotëruesit, janë të destinuara për formimin, ndryshimin ose montimin e mjeteve lundruese.

KREU IX

Neni 16
Ruajtja gjyqësore e mjeteve të sekuestruara e të konfiskuara

Mjetet lundruese, të sekuestruara e të konfiskuara në bazë të këtij ligji, i besohen në ruajtje institucionit përgjegjës për Rezervat Materiale të Shtetit.

Neni 17
Përdorimi i mjeteve të konfiskuara

1. Mjetet lundruese që kanë kryer shkeljet e parashikuara në nenin 14, pika 1, shkronja "i", të këtij ligji, pasi konfiskohen, bëhen pronë e shtetit.

2. Institucioni përgjegjës për Rezervat Materiale të Shtetit, sipas akteve ligjore në fuqi, me kërkesë të Departamentit për Kufirin e Migracionin dhe me miratim të organeve përgjegjëse, mjetet lundruese të konfiskuara ia jep në përdorim Policisë së Shtetit për kryerjen e detyrave institucionale.

Neni 18
Ankimi administrativ

1. Për masat administrative me gjobë dhe bllokim administrativ, të marra në bazë të këtij ligji, kundërvajtësi mund të bëjë ankim brenda 30 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim tek autoriteti kompetent që ka nxjerrë ose ka kompetencë të nxjerrë aktin.

2. Kur organi publik kompetent vlerëson se ankimi nuk është i pranueshëm dhe plotësisht i bazuar, pa vonesë dhe pa u shprehur mbi të, e përcjell atë për shqyrtim dhe vendimmarrje tek organi epror së bashku me të gjitha dokumentet përkatëse të dosjes dhe një raport me shkrim të qëndrimit të tij.

3. Ndaj vendimeve të marra sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, kundërvajtësi mund të bëjë ankim në gjykatën kompetente në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Neni 19
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 7, pika 5, të tij.
2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për transportin detar dhe ministria përgjegjëse për Policinë e Shtetit, që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzimin e përbashkët në zbatim të nenit 7, pika 6, të tij.
3. Ngarkohet ministria përgjegjëse për transportin detar, që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4, pikat 4, 6 e 7, dhe 13, pika 1, të tij.
4. Ngarkohen ministria përgjegjëse për transportin detar dhe ministria përgjegjëse për Policinë e Shtetit, që brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për rregullat dhe mënyrën e zbatimit të sanksioneve administrative të parashikuara në nenin 14 të tij.

Neni 20
Dispozitat kalimtare

Deri në vënien në funksionim të Regjistrit Elektronik të Mjeteve Lundruese, informacioni për regjistrimin e mjeteve lundruese do t'u dërgohet çdo muaj, në rrugë elektronike, drejtorive vendore të kufirit dhe migracionit të Policisë së Shtetit.

Neni 21
Dispozitat përfundimtare

1. Dispozitat e ligjit nr. 7873, datë 16.11.1994, "Për sekuestrimin e mjeteve tokësore, detare dhe ajrore, me të cilat kryhen vepra penale" nuk zbatohen për mjetet lundruese, objekt të këtij ligji.
2. Ligji nr. 8663, datë 18.9.2000, "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 15.10.2020